



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 338/8 Prot.

Tiranë, më 11.09.2017

V E N D I M

Nr.189, datë 11/09/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 173, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. nr. 173, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz",

VËREJ SE:

Në zbatim të Vendimit nr. 42, datë 19.04.2016, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Fushë-Arrëz", filloi mbikëqyrja e përgjithshme në subjektin, Bashkia Fushë-Arrëz. Ky proces u përmyll me Vendimin Nr.173, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Fushë-Arrëz, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse të drejtojë procesin administrativ për anulimin e të gjithë akteve të emërimit të konstatuara në raportin përfundimtar si akte administrative absolutisht të pavlefshme dhe të ndërpresë marrëdhëniet e paligjshme të punësimit të punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin. Për këtë qëllim, organi publik që i ka nxjerrë aktet e

emërimin në kundërshtim me ligjin (Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz), bazuar në pikën 1, neni 13, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, të veprorë si më poshtë:

- Punonjësit të emëruar në bashkinë e qytetit Fushë-Arrëz.
 - Të anulorë aktin nr. 38, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Përgjegjësi Sektori”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 33, datë 01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësen ***** në pozicionin “Inspektor Kontabiliteti”, në Sektorin e Financës dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë pikën 4, të aktit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Inspektor Pagash”, në Sektorin e Financës dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 34, datë 11.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësen ***** në pozicionin “Arkivist”, në Sektorin e Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 76, datë 01.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Inspektor i Planifikimit të Territorit” dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 33/1, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Inspektor për Koordinimin, Zhvillimin për Arsimin, Kulturën, Rininë, Sportet dhe Shëndetësinë”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 32/3, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Inspektor i Përballimit të Emergjencave Civile” dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë pikën 19, të aktit nr. 60/2, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Përgjegjësi Sektori”, në Sektorin e Shërbimeve dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë pikën 6, të aktit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësen ***** në pozicionin “Inspektor Veteriner”, në Sektorin e Shërbimeve, dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 32/4, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësen ***** në pozicionin “Përgjegjësi Sektori”, në Sektorin e Çështjeve Sociale dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 32/5, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësen ***** në pozicionin “Inspektor i Çështjeve Sociale” dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 32/6, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Përgjegjësi Sektori”, në Sektorin e Tatim Taksave dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
 - Të anulorë aktin nr. 32/7, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin ***** në pozicionin “Inspektor i Tatim Taksave” dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.

- *Punonjës të emëruar në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz.*
 - *Të anulojë aktin nr. 33/2, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Finance dhe Ndihmës Ekonomike”, në Njësinë Administrative Qafë Mali dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 11, datë 10.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësën *****, në pozicionin “Inspektor Protokolli”, në Njësinë Administrative Qafë Mali dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 5, të aktit nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor i Menaxhimit dhe Administrim-Territorit”, në Njësinë Administrative Qafë Mali dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 103, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Protokolli”, në Njësinë Administrative Blerim.*
 - *Të anulojë aktin nr. 103, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Ndihmës Ekonomike”, në Njësinë Administrative Blerim dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 3, të aktit nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësën *****, në pozicionin “Inspektor Protokolli”, në Njësinë Administrative Fierzë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 33/4, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Ndihmës Ekonomike dhe Financës”, në Njësinë Administrative Fierzë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 5, të aktit nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Tatim Taksa”, në Njësinë Administrative Fierzë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 1, të aktit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësën *****, në pozicionin “Inspektor Finance”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 2, të aktit nr. 60/4, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Protokolli”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 2, të aktit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Ndihmës Ekonomike”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 3, të aktit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Tatim Taksa”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë pikën 3, të aktit nr. 60/4, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Inspektor Veterinar”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*

- *Punonjës të emëruar në Shërbimin Pyjor, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz (funksione të deleguara).*
 - *Të anulojë aktin nr. 38/1, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 118, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 1/11, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 1/10, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*
 - *Të anulojë aktin nr. 47/1, datë 23.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.*

Pozicionet e mësipërme, njësia përgjegjëse t'i shpallë vende vakante dhe t'i plotësojë me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, apo zhvillimit të sistemit të karrierës (lëvizja paralele apo ngritja në detyrë) sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, si dhe në përputhje me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.

3. *Njësia përgjegjëse, bazuar në pikën 6, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nxjerrë menjëherë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil, për punonjësen *****, në pozicionin e punës “Jurist dhe Specialist për Prokurimet Publike”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz dhe ta vendosë atë në dosjen personale.*
4. *Organet kompetente (analisti i punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës) për hartimin e përshkrimit të punës, nën asistencën dhe kujdesin e njësisë përgjegjëse të institucionit, të plotësojnë menjëherë formularët e përshkrimit të punës për çdo pozicion pune pjesë të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*
5. *Mbas miratimit të përshkrimeve të punës, njësia përgjegjëse duke u bazuar në këto përshkrime, të bëjë ndarjen e qartë të pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, nga pozicionet e tjera për të cilat nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, duke i përcaktuar në mënyrë të specifikuar edhe në strukturën e institucionit, në një tabelë të dedikuar për këtë qëllim.*
6. *Njësia përgjegjëse të rishikojë emërtesat e pozicioneve të punës, sipas Lidhjes 3, “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin*

dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, duke ekuivalentuar emërtesat e pozicioneve të punës “Inspektor” e “Arkivist”, me emërtesat përkatëse të pozicioneve të punës të përcaktuara në nenin 19, pika 7, të ligjit për nëpunësin civil dhe Kreut II, “Klasifikimi” e Kreut III, “Grupet e pozicioneve të punës”, si dhe lidhja 3, që janë pjesë përbërëse të aktit nënligjor të përmendur më sipër, në përputhje me detyrat që kryejnë efektivisht në institucion.

7. Njësia përgjegjëse të rishqyrtojë strukturën organizative të institucionit, sipas parimit të hierarkisë administrative në shërbim civil, duke krijuar të paktën një njësi organizative në nivel drejtorie, ose nëse është e mundur më shumë se një të tillë. Njësia përgjegjëse të kujdeset që njësitë organizative në nivel sektori, t’i riorganizojë në bazë të identifikimit të kompetencave kryesore, në kuptim që pozicionet që kryejnë funksione të ngjashme, të grupohen në të njëjtën njësi organizative.

Për realizimin e kësaj procedure njësia përgjegjëse duhet t’i referohet standardeve të hartimit të strukturave organizative të përcaktuara në Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

8. Njësia përgjegjëse të drejtojë procesin e ristrukturimit, në bashkëpunim me Komisionin e Ristrukturimit, duke marrë parasysh strukturën përfundimtare të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, menjëherë pas hartimit të përshkrimeve të punës, dhe përcaktimit të kërkesave të përgjithshme e të posaçme për secilin pozicion, që është pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Përshkrimet e punës vlerësohen si një kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi, apo transferimi i punonjësve, për faktin se veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës ku mund të sistemohet punonjësi në kuadër të ristrukturimit. Organet kompetente, të tregojnë kujdes që ky proces të realizohet sipas udhëzimeve të mëposhtme:

- ✓ Të respektohen të gjitha kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreut III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ Procesi i ristrukturimit të fillojë me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili është organi kompetent për t’u shprehur në lidhje me mundësinë ose pamundësinë e sistemimit të secilit prej punonjësve ekzistues të institucionit, duke përfshirë dhe punonjësit *****; *****; *****; të trajtuar me vendim të Komisionerit në kuadër të inspektimit dhe rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për punonjësit ***** dhe *****.

Komisioni i Ristrukturimit të paraqesë para njësisë përgjegjëse propozimet përkatëse për emërim apo transferim të nëpunësve, në përputhje me kërkesat e vendit të punës dhe cilësitë personale të nëpunësit, në ndonjë prej pozicioneve të cilat janë të lira, të ristrukturuara, apo janë të plotësuara në mënyrë të kundërligjshme.

- ✓ *Vetëm në rast të pamundësisë së sistemimit të punonjësve sipas radhës së trajtuar më sipër, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbim civil për ta, duke u njohur atyre, të drejtat e parashikuara prej pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
 - ✓ *Komisioni i Ristrukturimit, propozimet për transferimin e punonjësve nga ristrukturimi, duhet t’i shoqërojë me relacionin përkatës, duke argumentuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe arsyet për të cilat kërkohet sistemimi ose pamundësia e sistemimit të punonjësve të institucionit, me komentet përkatëse, individualisht për çdo punonjës. Veprimet duhet të kryhen në përputhje të plotë me dispozitat e Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave dhe më tej, propozimet t’i paraqiten njësisë përgjegjëse të Bashkisë Fushë-Arrëz sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar.*
 - ✓ *Në përfundim të procesit, njësia përgjegjëse e bashkisë, në bazë të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, duhet të nxjerrë vendimin përfundimtar të transferimit, në mënyrë individuale për çdo nëpunës.*
9. *Pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, të përcaktuar në pikën 8, të këtij vendimi, njësia përgjegjëse të drejtojë procesin për të hartuar planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2017, në përmbajtje të të cilit të pasqyrohen vendet që do të mbeten vakante nga ristrukturimi. Ky plan të bëhet publik në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të institucionit dhe në stendat për njoftime publike të institucionit, sipas përcaktimeve në Vendimin nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.*
10. *Njësia përgjegjëse, pasi të miratojë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe ta bëjë publik sipas përcaktimeve të dispozitës më sipër, në bazë të tij, të fillojë procedurat e konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira nga ristrukturimi, sipas udhëzimeve të mëposhtme:*
- ✓ *Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të kujdeset që të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*

- ✓ *Të krijohen Komisionet përkatëse të vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë), sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.*
- ✓ *Njësia përgjegjëse të bëjë publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Fushë-Arrëz, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, dokumentet e nevojshme për kryerjen e procesit të rekrutimit:*
 - a) *Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil;*
 - b) *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”;*
 - c) *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”;*
 - d) *Aktin e shpalljes së kandidatit fitues, me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.*

11. *Njësia përgjegjëse të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e akteve të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2015 dhe vitin 2016, për të gjithë nëpunësit civilë të Bashkisë Fushë-Arrëz, sipas kërkesave të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Formularit të Vlerësimit nr. 2, bashkëngjitur dhe miratuar me Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.*

12. *Njësia e burimeve njerëzore të plotësojë dosjet e personelit të çdo nëpunësi civil sipas kërkesave të përcaktuara në rubrikën nr. 5, të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes që do të jetë pjesë e këtij vendimi si dhe dokumentet e evidentuara në anekset përkatëse bashkëlidhur raportit.*

13. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat 60 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr.173, dt.30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz”, të Komisionerit, me Vendimin Nr.116, datë 05.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 173, datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë, të cilët në datën 18.05.2017, u paraqitën pranë institucionit Bashkia Fushë-Arrëz.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 19.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Njësia përgjegjëse në zbatim të pikës 2 të vendimit të Komisionerit ka vepruar si vijon: Punonjësit e përmendur në pikën 2 të rekomandimit të Komisionerit vazhdonin marrëdhënien e punës me Bashkinë Fushë-Arrëz (*për shkak të kohës së shkurtër të lënë në dispozicion, nuk mund të anuloheshin dhe të ndërpritej në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punësimit, sepse do të kishte pasoja në funksionimin normal të punës së bashkisë*). Por nga ana tjetër, në zbatim të detyrimit për zbatimin e rekomandimit të Komisionerit, pozicionet e punës që mbanin punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, të cilët janë përmendur në pikën 2 të vendimit, janë shpallur të lira, fakt i cili provohet me shkresat nr. 807, datë 07.04.2017 dhe nr. 1180, datë 19.05.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të administruara nga grupi i verifikimit. Më konkretisht, me shkresën nr.807, datë 07.04.2017 “*Dërgim shpallje*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, është bërë shpallja për pozicionet e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm*” dhe “*Specialist i kadastrës*” dhe kishin filluar procedurat e konkurrimit duke përcaktuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme si dhe afatin për paraqitjen e dokumentacionit.

Ndërsa me Urdhrin nr.172, datë 12.05.2017, ishte bërë planifikimi i vendeve vakante sipas VKM nr.108, datë 26.02.2014 “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, ku përfshiheshin të gjitha pozicionet që mbanin punonjësit e përmendur në pikën 2 të vendimit si më poshtë:

- Pozicioni i punës “*Specialist Kontabiliteti*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist Pagash*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist Arkive*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist i Planifikimit të Territorit*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist për Koordinimin, Zhvillimin për Arsimin, Kulturën, Rininë, Sportet dhe Shëndetësinë*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist për Emergjencat Civile*”;
- Pozicioni i punës “*Përgjegjës Sektorit i Shërbimeve Publike*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist Veteriner*” (2 pozicione pune);
- Pozicioni i punës “*Përgjegjës Sektorit i Çështjeve Sociale*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist i Çështjeve Sociale*”;

- Pozicioni i punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim- Taksave”;
- Pozicioni i punës “Specialist në Sektorin e Tatim- Taksave”;
- Pozicioni i punës “Specialist Finance dhe i Ndhmës Ekonomike”;
- Pozicioni i punës “Specialist i Menaxhimit dhe Administrimit të Territorit”;
- Pozicioni i punës “Specialist i Ndhmës Ekonomike”(4 pozicione pune);
- Pozicioni i punës “Specialist i Protokollit” (3 pozicione pune);
- Pozicioni i punës “Specialist i Financës”.

Komisioneri Për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në paragrafin e tretë të pikës 2 të vendimit, ka rekomanduar njësinë përgjegjëse të bëjë anulimin e akteve administrative të emërimit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësit e shërbimit pyjor pranë Bashkisë Fushë Arrëz, për shkak se aktet kanë dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Më kokretisht:

- Të anulohet aktin nr. 38/1, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 118, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 1/11, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 1/10, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 47/1, datë 23.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjësin *****, në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Fushë-Arrëz, rezultoi se nuk ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit për punonjësit e shërbimit pyjor, por në zbatim të rekomandimit të Komisionerit, me Urdhrin nr.172, datë 12.05.2017, ishte bërë planifikimi i vendeve vakante sipas VKM nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Pozicioni që mbante punonjësi *****, për të cilin është kërkuar anulimi i aktit nr.1/10, datë 06.01.2015, i titullarit të institucionit, me shkresën nr.807, datë 07.04.2017 është shpallur i lirë dhe kishin filluar procedurat e konkurrimit duke përcaktuar kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, si dhe afatin për paraqitjen e dokumentacionit. Në përfundim të procedurës së konkurrimit të zhvilluar sipas përcaktimeve të ligjit për shërbimin civil, me aktin nr.8, datë 29.05.2017, është bërë emërimi i punonjësit “specialist” në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz. (Një kopje e gjithë dokumentacionit të konkurimit është administruar në dosjen e verifikimit).

Kjo pikë e vendimit do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë së Fushë-Arrëzit, bazuar në pikën 6, të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të rekomandimit të pikës 3 të vendimit të Komisionerit, me aktin administrativ nr.2, datë 13.03.2017, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësen ***** në pozicionin *“Jurist dhe specialist për prokurimet publike”*, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.
- Gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se, njësia përgjegjëse, në zbatim të rekomandimit të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, kishte hartuar dhe miratuar përkrahjet e punës sipas përcaktimeve të Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përkrahjet dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.
- Në zbatim të pikës 5, 6 dhe 7 të vendimit objekt verifikimi, njësia përgjegjëse pasi më parë ka hartuar dhe miratuar formularin e përkrahjes të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil ka bërë ndarjen e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil nga pozicionet e tjera për të cilat nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. Kjo ndarje është përcaktuar qartazi në strukturën e miratuar me Vendimin nr.11, datë 24.02.2017, të Këshillit Bashkiak, si dhe në strukturën e miratuar me Urdhrin nr.171, datë 12.05.2017, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.216, datë 29.12.2016, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, të Njësive administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të Bashkisë” të vitit 2017, ku janë klasifikuar pozicionet e shërbimit civil, sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, bazuar në përkrahjet e punës të çdo pozicioni.*

Në strukturën e mësipërme, është marrë në konsideratë dhe rekomandimi i Komisionerit në lidhje me riorganizimin e njësive organizative në bazë të kompetencave që kanë, referuar Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” (Sektori i Shërbimeve është bërë Drejtori e Shërbimeve Publike).*

- Në lidhje me rekomandimin e pikës 8 të vendimit, me Urdhrin nr.44/1, datë 15.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, sipas përcaktimeve ligjore të pikës 3 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Përsa i përket mundësisë së sistemimit të punonjësve ***** dhe ***** u provua se këto punonjës i ishin drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative. Për këtë arsye, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin sanksionohet se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”*, zbatimi i këtij rekomandimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

- Njësia përgjegjëse, në zbatim të rekomandimit të pikës 9 të vendimit të Komisionerit, ka drejtuar procesin për hartimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, i cili është

miratuar me Urdhrin nr.172, datë 12.05.2017, në përputhje me Vendimin nr.108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

- Në lidhje me rekomandimin e pikës 10 të vendimit të Komisionerit, për zhvillimin e konkurrimeve (*konkurrime që ishin në proces për pozicionet, përgjegjës i sektorit të auditit të brendshëm dhe specialist kadastrë*), njësia përgjegjëse në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike, me Urdhrin nr.44/2, datë 15.02.2017, ka krijuar “Komitetin e Pranimit për Ngritje në Detyrë”; Me urdhrin nr.44/3, datë 15.02.2017, ka krijuar “Komitetin e Pranimit për Lëvizje Paralele në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese” dhe me Urdhrin nr.44/4, datë 15.02.2017, ka krijuar “Komitetin e Përhershëm të Pranimit në Kategorinë Ekzekutive”. Janë bërë publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nën ligjore për procedurat e rekrutimit për pozicionet, përgjegjës i sektorit të auditit të brendshëm dhe specialist kadastrë e konkretisht:
- ✓ Akti i shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Akti përmban të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.

Procedura e konkurrimit ka mbetur në fazën e parë atë të shpalljes për të plotësuar dy pozicione të lira pune në shërbimin civil. (*Shpallje nr.807, datë 07.04.2017*).

- Në zbatim të rekomandimit të pikës 11 dhe 12 të rekomandimit të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse bazuar në nenin 62 të ligjit nr.152/2013 “për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, kishte bërë vlerësimet e punës për të gjithë nëpunësit dhe ishin administruar në dosjet e personelit. Po kështu dosjet e personelit ishin plotësuar me dokumentacionin e munguar, i cili ishte konstatuar gjatë procesit të mbikëqyrjes. (*Dëshmitë e penalitetit dhe raportet mjekësore*)

Nga sa u parashtrua më sipër, rezulton se njësia e burimeve njerëzore të institucionit Bashkia Fushë-Arrëz është përpjekur të zbatojë me korrektësi të gjitha detyrat e lëna në Vendimin nr. 173, datë 30.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz”*, të Komisionerit. Sa i takon procedurave të konkurrimit për pozicionet e punës, që kanë rezultuar të lira si rezultat i plotësimit në kundërshtim me procedurat e parashikuara në nenin 22 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (shpalljet nr. 807, datë 07.04.2017 dhe nr. 1180, datë 19.05.2017), ato do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe nenin 34 të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Fushë-Arrëz, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 173, datë 30.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz”*.
2. Njësia e burimeve njerëzore (*njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil*) dhe Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, në përfundim të procedurave të konkurrimit për pozicionet e punës, që kanë rezultuar të lira si rezultat i plotësimit në kundërshtim me procedurat e parashikuara në nenin 22 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (shpalljet nr. 807, datë 07.04.2017 dhe nr. 1180, datë 19.05.2017) të njoftojnë me shkrim Komisionerin, duke bashkëngjitur edhe aktet përkatëse.
3. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA